



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr 1449 prot.

Shkodër, me 22.01.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

**Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin “PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKB NR 1, DATË 22.01.2016 “PËR TAKSAT E
TARIFAT VENDORE NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

Me Vendim Delegimi

Zv. Kryetar

Alban PREKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 1949 prot.

Shkodër, më 22.9.2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë _____.2026

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKB NR 1, DATË 22.01.2016 “PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës ____/____ 2026, me propozim të kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9 pika 1.3, nenit 35 pika 1, nenit 54 shkronja (f) të ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “ të ndryshuar; Ligjit nr 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Ligjit nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar si dhe relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër

V E N D O S I:

1. Të miratoj ndryshimet dhe shtesat në VKB-në nr 1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifatat vendore në bashkinë Shkodër” të ndryshuar, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Efektet financiare të ndryshimit në paketën fiskale fillojnë në datën 01.02.2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë .
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Benet BECI

Me Vendim Delegimi

Zv. Kryetar

Alban PREKA

Zv/Kryetar

Alban Peka

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

ELVIN BEANIMI

Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit

DANIELA

Drejtoria e Kulturës

Sara Smejfa

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave
Vendore

Artur Behari

Drejtoria e Përgjithshme Juridike,
Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Mbështetëse

G. Deme

Drejtoria Juridike

B. Lapepe

Policia Bashkiake

SAIMIR R. MUSTEMI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Nr. _____ prot.

Shkodër, më _____.____.2026

RELACION

**“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKB NR 1, DATË 22.01.2016 “PËR
TAKSAT E TARIFAT VENDORE NË BASHKINË SHKODËR ”, TË NDRYSHUAR**

Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Në kuadër të kompetencave të njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e kulturës dhe promovimit të jetës artistike, si dhe në zbatim të misionit për garantimin e aksesit të barabartë të qytetarëve në shërbimet kulturore, Bashkia Shkodër tashmë ka vënë në funksion të plotë kinemanë Republika që përfaqëson kinemanë e parë publike në vend. Pas rikonstruksionit të plotë të saj, tashmë Kinemaja është shndërruar në një strukturë me kushte bashkëkohore infrastrukturore, teknologjike dhe funksionale.

Meqënëse Kinemaja përbën një strukturë të rëndësishme kulturore, me ndikim të drejtpërdrejtë në edukimin artistik, zhvillimin social dhe gjallërimin e jetës kulturore të komunitetit, administrimi nga Bashkia siguron që shërbimi i kinemasë të jetë i aksesueshëm për të gjithë me një program të larmishëm, gjithëpërfshirës dhe edukues

Bashkia Shkodër në paketën fiskale të miratuar me Vendim të këshillit bashkiak nr. 1 datë, 22.01.2016 “Për taksat e tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar ka miratuar vlerën e biletave të diferencuara sipas shfaqjeve, kategorive apo strukture të Kinemasë. Ky diferencim i biletës sjell vështirësi në administrimin dhe raportimin e të ardhurave dhe paqartësi për publikun në lidhje me çmimin e biletës.

Sa më sipër, kërkohet unifikimi i vlerës së biletës së Kinema Republika dhe miratimi saj në vlerën 500 lekë në ditët enjte-e diele dhe 300 leke në ditët e martë dhe e mërkurë.

Ndryshimi dhe unifikimi i vlerës së biletës së kinemasë paraqitet si një masë e nevojshme, e cila kontribuon në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe ofrimin e një shërbimi më transparent dhe të standardizuar.

Gjithashtu, Qendra Rinore Atelie, ka propozuar që studentët e pajisur me kartë studenti të përfitojnë tarifën e biletës në masën 50% të vlerës të plotë për biletat e Kinema Republika. Ky lehtësim ndikon në rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitetet kulturore të qytetit dhe siguron akses më të lehtë dhe të barabartë për ta në shërbimet kulturore, në përputhje me objektivat e Kartës së Studentit.

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; VKB Nr.1, datë 22.01.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar; Ligji nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar;

Propozojmë për miratim Keshillit Bashkiak projekt vendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në vkb nr 1, datë 22.01.2016 “Për taksat e tarifave vendore në bashkinë Shkodër”, të ndryshuar, sipas tabelës si më poshtë:

IV.1	Emertimi	Njesia	Vlera
a)	Dhënie për përdorim e sallës për film	Lekë/seance screening	15.000 lekë
b)	Dhënie për përdorim e sallës për film (premierë kombëtare/ndërkombëtare)	Lekë/seance screening	0 lekë
c)	Dhënie për përdorim e sallës për film (festival)	Lekë/ditë	5000 lekë
d)	Dhënie për përdorim e sallës për teatër (eksperimental)	Lekë/orë	10.000 lekë
e)	Dhënie për përdorim e sallës për teatër (experimental/premierë)	Lekë/orë	0 lekë
f)	Dhënie për përdorim e sallës për balet kontemporan, pikturë sensoriale, video art, koncerte për dhomë (chamber)	Lekë/orë	10.000 lekë
g)	Dhënie për përdorim e sallës për balet kontemporan, pikturë sensoriale, video art, koncerte për dhomë (chamber premiera)	Lekë/orë	0 lekë

h)	Dhënie për përdorim e sallës për teatër kukullash	Lekë/orë	5000 lekë
i)	Bileta për film (e enjte- e diele)	Lekë/bileta	500 lekë
	Bileta për film (e enjte- e diele)- për invalidët e punës, paraplegjikët e tetraplegjikët dhe të verbërit	Lekë/bileta	250 lekë
	Bileta për film (e enjte- e diele)- për fëmijët që kanë statusin e jetimit	Lekë/bileta	250 lekë
	Bileta për film (e enjte- e diele) - për personat me aftësi të kufizuara fizike, mendore, shqisore dhe personat që nuk dëgjojnë	Lekë/bileta	250 lekë
	Bileta për film (e enjte- e diele) - për familjet përfituese të ndihmës ekonomike	Lekë/bileta	250 lekë
	Bileta për film (e enjte- e diele)- për fëmijët të cilët u është dhënë statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës	Lekë/bileta	250 lekë
	Bileta për film (e enjte- e diele) - për personat që u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane	Lekë/bileta	250 lekë
j)	Bilete per student (i pajisur me karte studenti)	Lekë/bileta	250 lekë
k)	Bileta për film (e martë-e mërkurë)	Lekë/bileta	300 lekë
	Bileta për film (e martë-e mërkurë)- për invalidët e punës, paraplegjikët e tetraplegjikët dhe të verbërit	Lekë/bileta	150 lekë
	Bileta për film(e martë-e mërkurë) - për fëmijët që kanë statusin e jetimit	Lekë/bileta	150 lekë
	Bileta për film (e martë-e mërkurë) - për personat me aftësi të kufizuara fizike, mendore, shqisore dhe personat që nuk dëgjojnë	Lekë/bileta	150 lekë
	Bileta për film(e martë-e mërkurë) - për familjet përfituese të ndihmës ekonomike	Lekë/bileta	150 lekë

	Bileta për film (e martë-e mërkurë) për fëmijët të cilët u është dhënë statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”	Lekë/bileta	150 lekë
	Bileta për film (e martë-e mërkurë)- për personat që u përkasin pakicave romë dhe egjiptiane	Lekë/bileta	150 lekë
l)	Bilete për student (i pajisur me kartë studenti)	Lekë/bileta	150 lekë
m)	Dhënie e sallës në përdorim për mbledhje, takime etj	Lekë/orë	20,000 lekë

Propozim Policia Bashkiake

Propozime Policia Bashkiake

Në vijim të zbatimit të detyrave funksionale dhe duke evidentuar problematika apo masa të nevojshme që duhen ndërmarrë propozojmë që të kemi shtesa dhe ndryshime sa i përket gjobave dhe kundravajtjeve të lidhura me qarkullimin rrugor, tregtimit të pa licencuar, keq trajtimit të kafshëve si dhe shkelje të normave të sjelljes në ambientet publike :

1. Shtesë (IV.3.3/9 Mosrespektim i tabelave të qarkullimit rrugor, dhe tabelave të tjera kufizuese të vendosura nga organet kompetente Lekë/rast 5.000).
Propozojmë që niveli i gjobës të variojë nga 5,000 deri në 20,000 lekë, duke u bazuar në larminë e llojeve të shkeljeve, si dhe në tipologjinë e mjeteve të përfshira, përfshirë motomjetet dhe automjetet e tonazheve të ndryshme.
2. Shtese (IV.3.3 pika 2- Shitje e lëndëve djegëse pa licensë, për përdorim nga konsumatorët fundorë Lekë/rast 15,000)
3. IV. 3.7 -Niveli i gjobave për kundravajtje në normat e sjelljes, propozojme të shtohet dhe masa administrative (gjoba) si me poshtë:

Veprime të turpshme në ambiente publike 5000-20,000

4. IV. 3.2 pika 6- Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, propozojme të shtohet masa administrative si me poshte:

Keqtrajtimi i kafshëve 5000-20,000

5. Në rastet e zhvendosjes së automjeteve me karrotrec për shkak të shkeljeve të rregullave të qarkullimit apo parkimit të gabuar, aplikohen tarifa si me poshtë:

- Sherbim i transportit të mjeteve të bllokuara me karrotrec
Motoçikleta dhe ciklomotorë 5000 leke
- Sherbim i transportit të mjeteve të bllokuara me karrotrec
Për automjete 10,000 leke

Referuar rregullores "PËR CAKTIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSET PËR TO NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË SHKODER" - neni 26

1. Gjobat paguhen vullnetarisht brenda 10 ditëve; pas kalimit të afatit të parashikuar, zbatohet një kamatëvonesë prej 2% (dy përqind) mbi masën e gjobës, për çdo ditë vonesë. Shurna totale e kamatëvonesave nuk mund të tejkalojë masën e gjobës.

2. Në rast të pagesës së gjobës brenda 5 (pesë) ditëve në mënyrë vullnetare, kundravajtësi përfiton 30% (tridhjetë për qind) zbritje të vlerës së gjobës.

Gjobat do të paguhen pranë bankave të nivelit të dytë, apo pranë Filialit Posta Shqiptare sh.a. Shkodër ose ente të tjera të ligjshme.

Gjobat e Policisë Bashkiake për kundravajtjet rrugore, vendosen bëhen sipas përcaktimeve të Kodit Rrugor.

Ishte:

Në lidhje me masën plotësuese në rast të zhvendosjes së automjeteve me karrotrec, sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje, merret masa 3000 (tre mijë) deri në 10000 (dhjetë mijë) lekë, përshkallëzuar sipas llojit të mjetit, dhe distancës nga pika e heqjes së mjetit deri në pikën e ruajtjes/bllokimit, konkretisht:

- në distancën deri në 10 km paguhet vlera 3.000 lekë;
- në distancën nga 10 deri në 40 km paguhet vlera 6.000 lekë;
- në distancën 40 km deri në 70 km paguhet vlera 8.000 lekë;
- 70 km deri 100 km paguhet vlera 10.000 lekë.

Bëhet

Në rastet e zhvendosjes së automjeteve me karrotrec për shkak të shkeljeve të rregullave të qarkullimit apo parkimit të gabuar, aplikohen tarifat si më poshtë;

- Sherbim i transportit të mjeteve të bllokuara me karrotrec;

Motoçikleta dhe ciklomotorë	5.000 lekë
-----------------------------	------------
- Sherbim i transportit të mjeteve të bllokuara me karrotrec;

Për automjete	10.000 lekë
---------------	-------------

Ishte;

- Për masën plotësuese të bllokimit/ruajtjes së mjetit të hequr, paguhet shpenzimi i parkimit në vlerën 200 (dyqind) lekë/ditë për motorë e ciklomotorë; 500 lekë për automjete (vetura 4+1, 6+1); 700 lekë/ditë për automjete (8+1); 1.000 (njëmijë) lekë/ditë autobuzë, kamion etj.

Bëhet

Masa Plotësuese: Bllokimi dhe Ruajtja e Mjetit

Përveç gjobës, paguhet edhe shpenzimet ditore të parkimit/ruajtjes së mjetit të bllokuar në ambientet përkatëse, të cilat parashikohen si më poshtë;

Tarifa për qëndrim të automjeteve në pikën e bllokimit të Policisë Bashkiake

Lloji i Mjetit	Tarifa Ditore e Parkimit - Ishte	Tarifa Ditore e Parkimit - Bëhet
Motoçikleta dhe ciklomotorë	200 lekë/ditë	500 lekë/ditë
Automjete (vetura 4+1, 6+1)	500 lekë/ditë	2,000 lekë/ditë
Automjete (vetura 8+1)	700 lekë/ditë	2,500 lekë/ditë
Mjete me tonazh të lartë	3,000 lekë / ditë	3,000 lekë/ditë

Zbatimi i këtyre penaliteteve i ngarkohet Policisë Bashkiake, e cila regjistron gjobat në sistemin informatik të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Shkodër dhe ndjek deri në fund, nga ana ligjore arkëtimin e tyre.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore llogarit kamatëvonesat e gjobave.

Për çdo rast dëmtimi të aseteve publike, krahas masës administrative, subjektet janë të detyruara që të kthejnë ambientin në gjendjen e mëparshme, ose të zhdëmtojnë vlerën e dëmit të shkaktuar sipas vlerësimit nga institucioni përgjegjës.

Përfshihen nga pagimi i gjobave vetëm rastet përjashtimore të parashikuara në Ligjin Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative.

KRYETAR

Benet Beci

Me Vendim Delegimi

Zv. Kryetar

Alban PREKA



Zv/Kryetar

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave

Vendore

Artur Behari

Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit

Drejtoria e Kulturës

PANDI LACI

Policia Bashkiake

SAIMIR RUSTEMI

Seni Smajlaj